



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr.961/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,
Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.E. nga Gj., për shkak se ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-ës, dhe veprën penale falsifikim të dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, PP/II.nr.262/14 të dt.26.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **07.08.2018**, në prezencën e Prokurores së shtetit Mone Sylja, të akuzuarit, të dëmtuarit, të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, me datën **15.08.2018** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.E.**, i biri i J. dhe i ëmës N. e gjinisë M. , data e lindjes..., tani me banim në Gj., Rr.”N. T.” nr...../...,kati i ... -të, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme , shqiptar, shtetas i R.së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

I. Se me datën 10.04.2013 rreth orës 12.40 minuta, në Gjakovë, në lagjen “D.” pikërisht në firmën “B.R.C.” i keqpërdorë autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo ti shkaktoi dëm personit tjetër të dëmtuarit Q. H. nga fsh.S. K.Gj., në atë mënyrë që i pandehuri A. së bashku me dëshmitarin A. M. nga Gj., shkojnë në firmën e sipër cekur dhe e marrin me qira veturën e markës “P.” me ngjyrë të zezë me tabela të regjistrimit në kohë prej dy ditësh, ku i paguan 100 euro, dhe pas dy ditëve me dt.13.04.2013 shkon dëshmitarit A.M. dhe bënë pagesën në shumë prej 100 euro edhe për dy ditë të tjera në emër të pandehurit, me arsyetim se ai kishte shkuar në R.e Shqipërisë të qëndroi edhe dy ditë, ndërsa vetura merret nga i pandehuri nga ana e policisë dhe i kthehet të dëmtuarit.

- me çka ka kryer veprën penale, të keqpërdorimit të besimit, nga neni 342 par.1 të KPRK-së.

II. Ndërmjet datës 10-14-04.2013 në vend të pacaktuar, përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdorë dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar, në atë mënyrë që pasi që i pandehuri e merr automjetin e markës “... ..” me tabela të regjistrimit , me qira në

firmën “B.R.C.” pronë e të dëmtuarit Q. H. nga fsh.S. K.Gj.,dhe ia falsifikon librezën e qarkullimit me numër

- me çka ka kryer veprën penale, te falsifikimit te dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,46,49,50,51,73, dhe neni 342 par.1 të KPRK-së dhe neni 398 par.1 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPK-ës.

G J Y K O N

1.Për veprën penale, të keqpërdorimit të besimit, nga neni 342 par.1 të KPRK-së, të përshkruar në dispozitivin e I-rë të Aktakuzës, dënim me kusht duke e vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6(gjashtë)muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1(Një)viti**, nuk kryen ndonjë vepër të re penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200.-(Dyqindë)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

2. Për veprën penale falsifikim të dokumentit, nga neni 398 par.1 të KPRK-ës, të përshkruar në dispozitivin e II-të të Aktakuzës, dënim me gjobë në shumë prej **500.-(pesqindë)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Për dy vepra penale, për të cilat është shpallur fajtor, në kuptim të nenit 80 par.2 pika 2.2 të KPRK-ës, i shqipton **dënim unik** me gjobë në shumë prej **700.-(shtatëqindë)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me kusht duke e vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6(gjashtë)muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1(Një)viti**, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **35(tridhjetë e pesë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës**.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

I dëmtuari Q.N. H. nga fsh.S. K.Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I SHQIPTOHET dënimi plotësues – konfiskimi i lejes së qarkullimit me nr.C..... në emër të A.E. , i cili është objekt i kësaj vepre penale, komfor neni 62 par.1 dhe 2 nën par.2.6 të KPRK-ës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.262/2014, të datës 26.12.2017, kundër të akuzuarit A.E. nga Gj., për shkak se ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-ës, dhe veprën penale

falsifikim te dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, Prokurorja e shtetit Mone Sylja, në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A.E. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohem, ashtu siç janë përshkruar në dy dispozitiva të aktakuzës, të përmirësuar nga ana e prokurores në seancën e sotme ,për të cilat vepra jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se vepra të tilla nuk do të përsëris ,tani jam në vuajtje të dënimit për vepra tjera penale ,por kjo është vepra e fundit që unë kam kryer ,vuajtja e dënimit me burg ka ndikuar mjaftë në rehabilitimin tim ,prandaj pas përfundimit të vuajtjes së dënimit do të kthehem jetës normale ,do të fillojë të punojë dhe të kontribuojë në familje, në atë kohë kur kam kryer këto vepra penale kam qene shume i ri dhe nuk kam ditur pasojat e kryerjes se kësaj vepre, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, mundësisht që të me shqiptojë një dënim të kushtëzuar pasi që kjo është vepra e fundit që unë kam kryer dhe nuk është iniciuar ndonjë rast tjetër penal .

I dëmtuari Q.H. , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bere nga ana e te akuzuarit ,vlerësojë korrektesën e tij dhe pendimin për veprën e kryer ,automjeti i përshkruar në dispozitivat e aktakuzës me është kthyer në gjendje të rregullt teknike si dhe leja e qarkullimit origjinal me është kthyer, sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit i le gjykatës në vlerësim ,ndërsa nuk kërkojë kompensim demi ,pasi që i njëjti përmes shokut të tij me ka kërkuar falje për veprat e kryera dhe të njëjtit ia kam falur gabimin .

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurorja e shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A.E. ; **I.** Se me datën 10.04.2013 rreth orës 12.40 minuta, në Gjakovë, në lagjen “D.” pikërisht në firmën “B.R.C.” i keqpërdorë autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo ti shkaktoi dëm personit tjetër të dëmtuarit Q.H. nga fsh.S.K.Gj., në atë mënyrë që i pandehuri A.së bashku me dëshmitarin A.M. nga Gj., shkojnë në firmën e sipër cekur dhe e marrin me qira veturën e markës “...” me ngjyrë të zezë me tabela të regjistrimit në kohë prej dy ditësh, ku i paguan 100 euro, dhe pas dy ditëve me dt.13.04.2013 shkon dëshmitarit A.M. dhe bënë pagesën në shumë prej 100 euro edhe për dy ditë të tjera në emër të pandehurit, me arsyetim se ai kishte shkuar në R. e Shqipërisë të qëndroi edhe dy ditë, ndërsa vetura merret nga i pandehuri nga ana e policisë dhe i kthehet të dëmtuarit.

II.Ndërmjet datës 10-14-04.2013 në vend të pacaktuar, përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdorë dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar, në atë mënyrë që pasi që i pandehuri e merr automjetin e markës “...” me tabela të regjistrimit , me qira në firmën “B.Re.C.” pronë e të dëmtuarit Q. H.nga fsh.S. K.Gj. ,dhe ia falsifikon librezën e qarkullimit me numër

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, e sidomos faktin se i dëmtuari nuk kërkon kompensimin e dëmit, automjeti i është kthyer në gjendje të rregullt teknike dhe se të njëjtit ia ka falur gabimin, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata morri rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljet e mëparshme të kryesit, i njëjti më parë ka kryer vepra penale, intensiteti e rrezikimit apo dëmit të vlerës së mbrojtur, Gjykata ka ardhur në përfundim se me **dënim unik** me gjobë në shumë prej **700.-(shtatëqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me kusht duke e vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6(gjashtë)muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1(Një)viti**, nuk kryen ndonjë vepër të re penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.961/17 me datë 15.08.2018

Numri i lëndës: 2018:029817
Datë: 15.08.2018
Numri i dokumentit: 00101972

**Sekretarja juridike
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.